



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V

Komisioni për bujqësi, pylltari, mjedis dhe planifikim hapësinor

Mbledhja nr. 27

Prishtinë, më 27.1.2016, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL

i mbledhjes së komisionit për bujqësi, pylltari dhe mjedis e planifikim hapësinor

Në mbledhje morën pjesë : Fikrim Damka, Adem Salihaj, Murat Hoxha, Shaip Muja, Srdjan Popović dhe Emilija Redžepi.

Munguan : Lahi Brahimaj, Haxhi Shala, Salih Salihu.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë sipas listës së nënshkrimeve.

Stafi mbështetës i Komisionit : Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Fikrim Damka**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 18.12.2015,
3. Shqyrtimi i planit vjetor të punës në Komision,
4. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për monitorimin e Ligjit për Inspektionin bujqësor,
5. Te ndryshme ;

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me shtesa të propozuara për rendin e ditës : **për punën e GP për Obiliqin, dhe përfundimin e kryesisë për demarkacionin me Malin e Zi.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës për këtë mbledhje u miratua duke shtuar një pikë për Obiliqin dhe një tjetër në kuadër të pikës të ndryshme

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18.12.2015

Procesverbali 18.12.2015 dhe ajo e sodit do të miratohen në mbledhjen e nesërme.

3. Raporti dhe Rekomandimet për monitorimin e Ligjit për Inspektionin bujqësor

Kryetari Fikrim Damka në fillim falënderoi për punën e grupit punues për monitorimin e këtij ligji dhe i japi fjalën kryesuesit të tij z. **Adem Salihaj** i cili u fokusua në çështjet që përfshijn raportin dhe problemet kryesore gjatë punës së grupit punues, kurse nga të ftuarit (përfaqësues të APK, AUV dhe MB) kërkoi mendimin se a janë këto draft rekomandime ato që duhet ti miratoi Kuvendi apo duhet të plotësohen. **Shefki Zeqiri** nga MB fillimisht u pajtua me konstatimet dhe rekomandimet e sugjeruara nga grupi punues të cilat tha se do të janë pjesë e punës në MB, gjithashtu japi informacione shtesë për sfidat aktuale dhe ato të reja në ministrinë e bujqësisë ku do të aplikohet edhe organizimi i ri sipas rekomandimeve nga agjencia evropiane. **Ahmet Zejnullahu** potencoi faktin se inspektioni i pyjeve pas kalimit në agjencinë e pyjeve nga roli monitorues ka marrë rolin përgjegjës, megjithatë ajo paraqet forcë të pamjaftuar me 12 inspektorate, autoritetet komunale nuk kanë inspektora, të hyrat janë të përgjithshme kurse ato komunale nga krijimi i tyre i ndajnë për vëdi 30%. Sa i përket rekomandimeve ato i përkrahu në tërësi pa ndonjë sugjerim për plotësim. **Kryetari Fikrim Damka** dhe **Adem Salihaj** kërkuan disa sqarime rreth të hyrave komunale, kryetari ndërhyri me një pyetje rreth krijimit të hyrave në komuna gjatë shitjes së drunjve dhe konfuzitetin që krijohet me çmime dhe pyeti a ka mundësi të rregullohen këto parregullsi me ligj sidomos gjatë furnizimit të shkollave me drunj. **Z. Zejnullahu** potencoi se këto procedura të furnizimit i parasheh Ligji i prokurimit dhe përgjegjësia është tek komunat dhe në vazhdim u sqaruan edhe disa çështje të kërkuara nga deputetët e cekur duke u bashkëngjitur në sqarime edhe **Shefki Zeqiri**, ndaj u kërkua nga z. **Salihaj** që mundësisht të gjendet një procedurë ligjore për këto çështje me rëndësi. Gjatë diskutimeve u bashkëngjiti **Murat Hoxha** i cili mysafirëve ju sqaroi kërkesën e këtij komisioni se ata duhet të japin sugjerime a ka nevojë ky raport të përmbajë ndonjë rekomandim tjetër apo mjaftojnë këto për ndryshimin e gjendjes në inspektionin bujqësor dhe ilustroi diskutimin dhe kërkesën e tij me një shembull konkret për efikasitet më të lartë rreth lëndëve të shumta nëpër inspekcione. **Emilija Redzeqi** poashtu ilustroi brengën e shfaqur gjatë punës në terren dhe mungesën e inspektorëve, ndaj në këtë drejtim duhet të bëhet riorganizimi, fillimisht duke shtuar numrin e inspektorëve. **Adem Salihaj** u interesua për lëvizjen e inspektorëve në inspektionin bujqësor me çka ka ardhur deri te shuarja, mirëpo kundërshtoi z. Zeqiri ngase ata në MB

siç tha ai, kanë prioritete në bazë të cilave duhet të punojnë dmth bëjnë bartjen e inspektorëve diku ku është më tepër e nevojshme. **Ismet Fejzullahu** shef i sektorit fitosanitar në AUV përkrahu rekomandimet por ceku se rekomandimi i parë është në kundërshtim me të dytin, ndaj mendoj se duhet ndryshuar në tërësi ligji, për çka reagoi **z. Salihaj** se strategjia legislative përfshinë një ligj për inspektime por duhet të shihet çka do të përfaqësoi ai ligj.

Fikrim Damka përmbylli këtë pikë duke kërkuar që deri nesër të dërgohen plotësimet eventuale, kur do të miratohet raporti në fjalë.

4. Shqyrtimi i planit vjetor

Fikrim Damka gjithashtu për planin e punës parashtrori kërkesën për anëtarët e pranishëm të dërgojnë ndonjë sugjerim nëse kanë deri nesër për plotësim, kurse **Murat Hoxha** kërkoj monitorimin e Ligjit për Kadastër , çka u miratua për 6 mujorin e parë të vitit, kurse për 6 mujorin e dytë të sjellët propozimi nesër. **Kryetari** poashtu kërkoj një risi të futet në planin vjetor të komisionit rreth mbikëqyrjes buxhetore të ministrive që veprojnë në fushën e komisionit, ngase kjo është kërkuar sipas raportit të progresit.

5..Projektligji për Obiliqin

Lidhur me projektligjin për Obiliqin fjalën e mori kryesuesi i GP **Shaip Muja** i cili tha se nga njoftimet që kanë marr anëtarët e komisionit kanë mundur të shohin se ka probleme të theksuara lidhur me këtë projektligj të miratuar në parim, ndaj në vazhdim të punës duhet të veprohet shumë konkretisht ose të propozohet me u tërheq ky projekt, në fakt ai sqaroi se ministrat e ftuar në grup punues nuk përgjigjen por dërgojnë përfaqësues të stafit të tyre, me çka vërtetohet se nuk janë të gatshëm për kontribut konkret : për tantimën për këtë komunë, zbutjen e çmimit të rrymës për këtë komunitet dhe mbrojtjen shëndetësore-qendra e mjekësisë familjare. Ai tha se i mendimit është të shkruaj komisionit dhe të ndikoi tek Kryeministri, përndryshe mbetet varianti i miratimit të ligjit me rrezikim të jozbatueshmërisë. **Fikrim Damka** pyeti a rregullohet gjendja nëse organizohet dëgjimi publik, por përgjigja ishte jo ngase këtu nuk janë në pyetje modalitetet por bllokada financiare dhe bllokatat tjera. **Murat Hoxha** rikujtoi se ky projekt u shqyrtua edhe një herë në Kuvend por pa sukses, ndaj ishte i mendimit se ministrat që janë ftuar në GP nuk kanë mjaft kompetenca për çka edhe nuk vijnë për kontribut, ndaj për shkak të problemeve ligjore ai sugjeroi të drejtohet komisioni tek kryeministri, pastaj Qeveria të tregoj rrugën. Ai lavdëroi kryetarin e komunës së Obiliqit i cili ka shprehur konstruktivitet duke kërkuar nëse asgjë tjetër vetëm eliminimin e problemeve të Obiliqit. **Adem Salihaj** u pajtua që ti dërgohet qeverisë përkatësisht kryeministrit një letër koncizë për të rezultuar me zgjidhje konkrete, ndoshta edhe me propozim për një ligj për zonat e rrezikuara ngase menjëherë mund të ankohen komunat tjera me ndotje mjedisore. **Shaip Muja** falënderoi dhe sugjeroi stafin të përdor shkresën e tij të mëhershme dërguar komisionit dhe të përdor atë si bazë për të dërguar qeverisë përkatësisht kryeministrit një shkresë të kompletuar me faktet që janë evidentuar në grupin punues. **Fikrim Damka : përmbylli këtë pikë me konstatimin se kjo shkresë duhet të përgatitet për dërgim Qeverisë.**

6..Të ndryshme

Fikrim Damka hapi diskutimin rreth përfundimit të Kryesisë së Kuvendit me të cilin angazhohet ky komision sa i përket demarkacionit me Malin e Zi.

Shaip Muja ishte i mendimit se ky përfundim i kryesisë është i vonshëm ngase qysh në shtator 2015 është dashur të aplikohet Neni 65.5 i rregullores por edhe i pikës 3 dhe 4 të njëjtit nen, si dhe Neni 70.4, ngase komisioni mund të ftoi subjektet për prova dhe të jetë anëtarë i nënkomisionit (p.sh. deputeti Shpëtim Bulliqi), kështu poçes ishte vepruar nuk do të bëheshin gabimet dhe nuk do të kishte nevojë për intervenime nga presidentja e vendit, ngase ajo nuk propozon ekspertizë ndërkombëtare por këtë e bënë Kuvendi përmes komisioneve funksionale, ai citoi edhe Rezolutën e Kuvendit nga 25.6.2015 pikën 2 dhe 6 ku sipas tij është caktuar Komisioni për punë të jashtme për raportim por jo si përgjegjës. Ai kërkoi formimin e grupit punues dhe konstatoi se me qëllim po shkohet nga krijimi i konfuzionit politik, por **Kryetari** tha se sot menjëherë jo ngase përfundimi i kryesisë tani është dhe duhet të realizohet duke ftuar deputetët kontributdhënës dhe punët rreth formimit të grupit punues ku duhet të marin pjesë gjithë anëtarët e komisionit që do të kryesohet nga deputeti i caktuar. **Adem Salihaj** tha se ky përfundim i kryesisë është totalisht e paqartë ngase Neni 65.5 tregon për angazhimin e këtij komisioni me komisionet tjera dmth Kryetari i Kuvendit manipulon me anëtarët e këtij komisioni, përndryshe nëse formohet GP atë duhet ta udhëheq kryetari i komisionit, përfundoi.

Fikrim Damka ceku edhe rolin e Komisionit të jashtëm që ju është dhënë dhe me të cilin duhet të bashkëpunohet. **Shaip Muja** tha se me këtë zhargitje që po dëgjohet këtu vetëm po arsyetohen protestat e opozitës, ngase përgjegjëse është pozita. Në vazhdim kishte polemika midis **Adem Salihajt** dhe **Shaip Mujës** në stilin : kush je ti, ju të LDK-së po doni mos të goditet kryeministri, askush nuk tregon lidrshp të vërtet derisa vendi dëmtohet, Adem Salihaj ka fobi ndaj kryetarit të kuvendit, unë nuk i tutna askujt dhe kaheerë e kam treguar veten kush jam, mbledhjet e komisionit nuk janë normale për shkak të ndërhyrjeve të Shaipit i cili etiketon, fyen në nivelin e ultë, etj etj. **Murat Hoxha** kundërshtoi kërkesën e z. Shaip që të ftohet komisioni shtetëror ngase me nënshkrimin e marrëveshjes ka përfundua edhe obligimi i komisionit që të jap llogari, por nëse vjen deri te rinogociimi ky komision parlamentar duhet të veproji me potencialin që e ka, por duhet të kemi parasysh edhe politikën, vazhdoi, sepse kjo marrëveshje dhe çdo marrëveshje tjetër ka edhe anën politike përveç asaj profesionale, ceku shembullin e Trieshtës e cila i është dhënë Italisë nga politika e jo nga profesionalistët, dmth politika mund të jetë vendimtare. **Emilija Redzepi** apeloj të mos bëhen sulme individuale ngase të gjithë deputetët duhet të nisen nga fakti që së pari duhet të bëhen konsultimet në GP dmth nuk ka nevojë për sulme individuale. **Fikrim Damka : nesër diskutohet në mbledhje si do të veproji komisioni.**

Përgatitur nga stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i Komisionit,
Fikrim Damka